



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-03

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 qershor 2017

Gjuha origjinale: Anglishte

Titulli: **Referimi i rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit**

PUBLIK

VENDIM

për gjuhën e punës në lidhje me Referimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE, i caktuar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji') dhe duke vepruar në bazë të nenit 20 të Ligjit, me anë të këtij vendimi cakton gjuhën e punës në procedurën para këtij paneli.

1. Më 31 maj 2017, në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese iu referuan rregullat e rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar më 29 maj 2017 me votim përmes mjeteve të komunikimit nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara, me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
2. Neni 20 i Ligjit parashtron se 'gjatë çdo procedure, ... paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurës'.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, dhe në përputhje me nenin 20 të Ligjit,

PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË VIJIM

vendos që gjuha e punës për procedurën në lidhje me referimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, të jetë **anglishtja**.

/nënshkrim/

Gjykatëse An Pauër-Ford

Kryetare

Hartuar në anglishte, e premte, 2 qershor 2017,
Në Hagë, Holandë.